



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA MONITORIMIT  
SEKTORI I STATISTIKAVE DHE PERFORMANCËS

Nr. 3825/3 Prot.

Elbasan, më 10.09. 2025

## PLANI I INTEGRITETIT

PËR BASHKINË ELBASAN

2025- 2028

Miratuar me vendimin nr. 104 datë...<sup>3.09.2025</sup> të Këshillit Bashkiak, Elbasan

Dokumenti “Plani i Integriteti” u përgatit nga bashkia Elbasan. Ky material u punua dhe u konsultua përgjatë një periudhe 3-mujore përmes diskutimeve konstruktive ndërmjet anëtarëve të grupit të punës, bashkëpunëtorëve grupeve të interesit.

Plani i Integritetit është punuar nga grupi i punës:

- Ervin Muço, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit,
- Lorena Haxhiymeri, Koorditore e Performancës
- Marsida Biba, Specialiste pranë Burimeve Njerëzore
- Enea Sanço, Përgjegjës pranë Drejtorisë së Prokurimeve dhe Investimeve.
- Eglantina Doko, Specialiste pranë Drejtorisë Financës dhe Buxhetit
- Ardiola Bajraktari, Specialiste pranë Drejtorisë së Auditit të Brendshëm
- Nadire Kreka – Koorditore e Barazisë Gjinore
- Ana Vrioni – Specialiste pranë Drejtorisë Juridike dhe Informacionit
- Aida Talelli – Koorditore e të Drejtës për Informim
- Eva Bica - Anëtar i Komisionit të Çështjeve Ligjore
- Andi Shtylla - Anëtar i Komisionit të Çështjeve Ligjore
- Anëtarët dhe anëtarët e Forumit të Qeverisjes së Hapur ( OGP )

*Ky plan integriteti është hartuar në kuadër të Komponentit “Zgjerimi i praktikës standarde të planifikimit të integritetit në nivel vendor”*

*“Mbështetja dhe avancimi i reformave të qeverisjes vendore”, në bashkëpunim me AMVV dhe me mbështetjen e Ministrisë së Shtetit për Pushtetin Vendor*

## DEKLARATA E INTEGRITETIT 2025–2028 BASHKIA ELBASAN



*Si Kryetar i Bashkisë Elbasan, kam kënaqësinë t'ju prezantoj Planin e Dytë Vendor të Integritetit 2025–2028.*

*Elbasani është një qytet dinamik, me një kulturë të gjallë dhe një shoqëri civile aktive. Modeli i bashkëpunimit midis Bashkisë Elbasan, komunitetit, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë në nivel lokal, kombëtar e ndërkombëtar, na ofron një mekanizëm të rëndësishëm që siguron përmirësimin e sistemit tonë të qeverisjes.*

*Të udhëhequr nga parimet e integritet, transparencës, ndershmërisë dhe llogaridhënies, Bashkia Elbasan shpall Deklaratën e Integritetit për periudhën 2025–2028, si pjesë përbërëse e Planit të Integritetit dhe Kodit të Sjelljes, të*

*miratuar nga Këshilli Bashkiak,*

*Për ne, integriteti nënkupton ushtrim i funksioneve publike me ndershmëri, paanshmëri dhe në përputhje të plotë me ligjin, duke vënë në qendër interesin publik. Besimi i komunitetit dhe bashkëpunëtorëve është themeli i veprimtarisë sonë – një vlerë që fitohet përmes veprimeve të qarta, të përgjegjshme dhe të matshme.*

*Për të ruajtur dhe forcuar këtë besim, angazhohemi që:*

- të ndërtojmë një kulturë organizative të bazuar në ndershmëri, respekt dhe përgjegjësi, që udhëheq çdo vendimmarrje dhe veprim institucional;
- të sigurojmë akses të lehtë, të barabartë dhe të kuptueshëm në informacionin publik për çdo qytetare dhe qytetar;
- të promovojmë pjesëmarrjen e barabartë të komunitetit në hartimin e politikave dhe buxhetit vendor, duke i kthyer zërat e komunitetit në veprime konkrete;
- të administrojmë me kujdes dhe vizion afatgjatë çdo aset publik, në shërbim të brezave të ardhshëm;
- të mbështesim dhe mbrojmë çdo individ që sinjalizon shkelje, duke bërë transparencën mjetin më të fuqishëm kundër korrupsionit;
- të investojmë në zhvillimin profesional dhe etik të stafit tonë, duke e kthyer atë në model të shërbimit publik me cilësi dhe integritet;
- të forcojmë bashkëpunimin me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë – si Partneriteti për Qeverisje të Hapur (OGP), OSBE, Bashkimi Europian dhe organizatat e shoqërisë civile – për të sjellë standardet më të larta në qeverisjen vendore.

*Zbatimi i kësaj Deklarate do të monitorohet dhe matet çdo vit përmes Raportit të Zbatimit të Planit të Integritetit dhe Indeksit të Besimit Publik "Trust Elbasan", duke garantuar transparencë të plotë dhe përmirësim të vazhdueshëm.*

*Kjo Deklaratë përfaqëson angazhimin tonë të palëkundur për të vepruar me integritet, për të forcuar llogaridhënien dhe për të ndërtuar një administratë vendore që u shërben të gjithë qytetarëve me dinjitet, drejtësi dhe barazi.*

**Kryetari i Bashkisë Elbasan**

**Gledian LLATJA**

**SHKURTESA**

| <b>Shkurtimi</b> | <b>Përshkrimi</b>                                                                         |
|------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------|
| AMVV             | Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore                                         |
| ASPA             | Shkolla Shqiptare e Administratës Publike                                                 |
| ASHK             | Agjencia Shtetërore e Kadastrës                                                           |
| BNJ              | Drejtoria e Burimeve Njerëzore                                                            |
| BE               | Bashkimi Evropian                                                                         |
| KB               | Këshilli Bashkiak                                                                         |
| DAP              | Departamenti i Administratës Publike                                                      |
| GPI              | Grupi i Punës për Integritet                                                              |
| KI               | Konflikti i Interesit                                                                     |
| NJVV             | Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore                                                          |
| PBA              | Programi Buxhetor Afatmesëm                                                               |
| PI               | Plani i Integritetit                                                                      |
| PP               | Përshkrim i Punëve                                                                        |
| PPV              | Plani i Përgjithshëm Vendor                                                               |
| PSV              | Procedura Standarde Veprimi                                                               |
| PVVBGJ           | Plani Vendor i Veprimeve për Barazinë Gjinore                                             |
| NJAB             | Njësia e Auditit të Brendshëm                                                             |
| CSO              | Civil Society Organization (Organizatë e Shoqërisë Civile)                                |
| OSHC             | Organizata e Shoqërisë Civile                                                             |
| OGP              | Partneriteti për Qeverisje të Hapur                                                       |
| KLSH             | Kontrolli i Lartë i Shtetit                                                               |
| SLA              | Marrëveshje për Nivelin e Shërbimit (Service Level Agreement)                             |
| KPI              | Tregues Kyç të Performancës (Key Performance Indicators)                                  |
| HRMIS            | Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore                                                |
| SIMRI            | Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit                                |
| UNCAC            | Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit                                       |
| ISO              | International Organization for Standardization                                            |
| ILDKPKI          | Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave |
| CSO Monitor      | Mekanizëm Monitorimi nga Shoqëria Civile për tenderë me vlerë të madhe                    |

## Përmbajtja

| Kapitulli                                                              | Faqe |
|------------------------------------------------------------------------|------|
| Preambulë .....                                                        | 3    |
| Shkurtësat .....                                                       | 6    |
| I. Plani i Integritetit .....                                          | 7    |
| II. Qëllimi dhe Objektivat .....                                       | 15   |
| III. Proçesi dhe Metodologjia .....                                    | 15   |
| 3.1. Hapat e Procesit të Hartimit .....                                | 17   |
| 3.2. Buxhetimi i Masave Prioritare .....                               | 19   |
| IV. Zbatimi dhe Sistemi i Monitorimit .....                            | 19   |
| 5.1. Strukturat përgjegjëse .....                                      | 20   |
| 5.2. Proçesi i ciklit vjetor .....                                     | 20   |
| V. Plani i Veprimit .....                                              | 36   |
| ANEKSI 1 – Mekanizmi i Monitorimit të Planit të Integritetit .....     | 37   |
| ANEKSI 2 – Përputhshmëria me Standardet Ndërkombëtare dhe Kombëtare .. | 37   |
| ANEKSI 3 – Mekanizmi i Sinjalizuesve dhe Mbrojtja e tyre .....         | 37   |

## I. Plani i Integritetit

**Plani i Integritetit 2025–2028** është angazhimi zyrtar i Bashkisë Elbasan për të parandaluar, zbuluar dhe trajtuar shkeljet e integritetit në të gjitha fushat e veprimtarisë institucionale, përfshirë shërbimet publike. Ai pason dhe përmirëson përvojën e akumuluar nga **Plani i Parë i Integritetit 2020–2022**, i cili ishte nisma e parë pilot e bashkisë për menaxhimin e riskut të integritetit në nivel vendor.

Plani i parë vendosi themelet për:

- mekanizmin e deklarimit proaktiv të konfliktit të interesit;
- publikimin në kohë reale të kontratave të prokurimit; dhe
- angazhimin qytetar në proceset vendimmarrëse.

Të tre këto masa janë ruajtur dhe zgjeruar në këtë plan të ri, i cili sjell përmirësime kyçe:

1. **Shtrirje afatgjatë** – mbulon një periudhë trevjeçare (2025–2028), duke siguruar vazhdimësi dhe stabilitet në zbatimin e masave.
2. **Shtylla të qarta veprimi** – masat janë të strukturuar në dy shtylla themelore: parandalim dhe zbulim.
3. **Përputhje me standardet kombëtare** – integron plotësisht Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030 dhe mbështetet në VKM nr. 241/2018 “Për miratimin e rregullave për hartimin dhe monitorimin e planeve të integritetit”.
4. **Buxhet i dedikuar** – parashikon një buxhet indikativ, të llogaritur sipas kostove të parashikuara në masat e planit, dhe krijon linjën e financimit “Integritet & Pjesëmarrje Qytetare” për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarëve në vendimmarrje dhe monitorim.
5. **Adoptim i praktikave më të mira** – merr në konsideratë përvojat e suksesshme të bashkive të tjera në Shqipëri, ku transparenca, pjesëmarrja qytetare dhe auditimi i brendshëm kanë dhënë rezultate të matshme.

### Përvoja e mëparshme (2020–2022)

Në vitin 2020, Bashkia Elbasan ndërmori për herë të parë hartimin dhe zbatimin e një Plani të Integritetit institucional, duke u bërë një nga njësitë e para të qeverisjes vendore që iu përgjigjën në mënyrë proaktive kuadrit kombëtar antikorrupsion dhe udhëzimeve të Ministrisë së Brendshme. Ky plan kishte për qëllim forcimin e mekanizmave të integritetit, transparencës dhe përgjegjshmërisë në strukturat administrative dhe u zbatua në përputhje me udhëzimet kombëtare të periudhës përkatëse.

Gjatë ciklit të parë të zbatimit (2020–2022), u realizuan masa të rëndësishme si: forcimi i rolit të Koordinatorës/Kordintorit të Integritetit, trajnime bazë mbi etikën për stafin, rritja e transparencës së vendimmarrjes në Këshillin Bashkiak dhe publikimi i dokumenteve bazë të menaxhimit financiar dhe prokurimeve. Megjithatë, u evidentuan edhe kufizime, si mungesa e indikatorëve të matshëm, e një skeme të qëndrueshme monitorimi dhe e përfshirjes së aktorëve të jashtëm.

Plani i ri 2025–2028 adreson këto mangësi, duke vendosur një sistem të integruar të menaxhimit të riskut të integritetit, me mekanizma të qartë për vlerësim, pjesëmarrje dhe transparencë, si dhe një sistem elektronik të thjeshtë e të aksesueshëm për monitorim dhe raportim periodik.

## II. Qëllimi dhe Objektivat

Ky kapitull përkufizon drejtimin strategjik të përpjekjeve të Bashkisë Elbasan për integritet gjatë periudhës 2025–2028. Ai paraqet misionin që udhëheq institucionin dhe objektivat strategjike që e përkthejnë këtë mision në rezultate konkrete, të matshme dhe të verifikueshme.

### Misioni:

Të krijojmë një administratë vendore që i kundërvihet korrupsionit, është transparente, inovative dhe e përgjegjshme për qytetaret dhe qytetarët, ku Këshilli Bashkiak (KB), administrata dhe shoqëria civile bashkëqeverisin në mënyrë etike, në përputhje me **Kodin e Sjelljes** dhe kuadrin ligjor kombëtar në fuqi.

### Objektiva specifike:

1) *Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Riskut të Integritetit (SIMRI), që do të funksionojë si mekanizmi qendror për identifikimin, vlerësimin dhe reduktimin e risqeve të korrupsionit në të gjitha njësitë organizative të Bashkisë Elbasan dhe që përbëhet nga tre komponentë kyç: SIMRI do të mbështetet në gjashtë shtylla të ndërthurura:*

1. **Kodi i Sjelljes & Regjistri i Nënshkrimeve** – dokument etik i përditësuar, i miratuar nga Këshilli Bashkiak, i cili nënshkruhet nga punonjëset dhe punonjësit, këshilltarët/këshilltarët dhe praktikantët/praktikantët. Kjo nënkupton detyrim personal për respektimin e standardeve të integritetit dhe një referencë të përbashkët për zgjidhjen e dilemave etike.
2. **Deklarata ad hoc e interesit** – këshilltarët dhe këshilltarët bashkiakë, si dhe anëtarët/anëtarët e komisioneve, dorëzojnë deklaratë për konflikt të mundshëm interesi sa herë që çështjet lidhen drejtpërdrejt me interesat e tyre. Formularët publikohen bashkë me procesverbalet përkatëse.
3. **One Stop Shop i përmirësuar** – përmes auditimit të plotë të rrjedhave të punës eliminohen duplikimet dhe vonesat; sistemi pajiset me server rezervë, back-up cloud dhe protokoll

emergjence; publikohen kohët standarde të shërbimit (SLA) dhe monitorohen me dashboard mujor KPI.

4. **Kontrolli i brendshëm i forcuar** – përfshin auditime të rregullta, monitorim të vazhdueshëm dhe raporte periodike mbi risqet dhe shkeljet, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm të parandalimit dhe reagimit.
5. **Vëzhgimi i jashtëm & përfshirja e shoqërisë civile** – zbatohet manuali “Prokurime Expertizash” dhe skema “CSO Monitor”, që lejojnë përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile si palë vëzhguese në tenderët e rëndësishëm dhe në proceset vendimmarrëse.
6. **Koordinatori/Koordinatorja Open Data** – rol i dedikuar për hapjen dhe publikimin e të dhënave, duke siguruar transparencë proaktive dhe akses publik për qytetarët dhe qytetarët mbi progresin e planit dhe vendimmarrjen e bashkisë.

**Tregues i ri matës për OS-1:** “% e rasteve të shkeljeve të etikës dhe/ose mosdiskriminimit të trajtuara nga autoritetet kompetente (AK/AKP)”. Ky tregues do të sigurojë matjen e reagimit institucional ndaj shkeljeve të raportuara, duke evidentuar jo vetëm numrin e rasteve, por edhe përqindjen e atyre që janë trajtuar dhe kanë marrë vendim përfundimtar nga autoritetet përkatëse. Rezultatet do të raportohen një herë në vit dhe do të publikohen në faqen zyrtare të bashkisë.

2) *Objektivi OS-2 – Transparencë & Llogaridhënie:* **Ky objektivi synon që faqja zyrtare e Bashkisë Elbasan të shndërrohet në një “Qendër të Dhënash në Kohë Reale”, ku qytetarët të kenë akses të menjëhershëm në buxhet, prokurime, vendimet e Këshillit Bashkiak dhe raportet e auditimit, të publikuara në formate PDF dhe CSV/JSON.**

#### **Publikim paraprak i projekt-vendimeve për koment publik**

1. Të gjitha projekt-vendimet me ndikim të gjerë (financiar, planifikues, rregullator) publikohen në faqen e Bashkisë për një periudhë **jo më pak se 10 ditë pune** para miratimit.
2. Publikimi shoqërohet me njoftim të qartë mbi mënyrën e dërgimit të komenteve dhe afatet përkatëse.



3. Ofron mundësi për qytetare, qytetarë dhe organizata të shoqërisë civile (OSHC) që të paraqesin rekomandime me shkrim.

**Treguesit:**

- % e ankesave të adresuara nga gratë dhe grupet vulnerabël.
- Ekzistenca e publikimeve të rregullta mbi performancën dhe ankesat sipas gjinive (Po/Jo).
- % e rasteve të sinjalizuara nga gra dhe/ose grupe vulnerabël.
- Ekzistenca e garancive për mbrojtjen e sinjalizuesve me fokus te individët nga grupet vulnerabël (Po/Jo)
- Ekzistenca e publikimit të buxhetit në formate të hapura (PDF + CSV/JSON) dhe përditësimi i tij çdo 6 muaj (Po/Jo).

**Komponentët kyç të OS-2 (2025–2028):**

1. **Buxheti i Hapur** – publikohen buxheti i miratuar, ekzekutimi gjashtëmuor dhe raporti vjetor; një dashboard interaktiv tregon shpërndarjen territoriale të investimeve.
2. **Prokurimet e Hapura** – regjistër dinamik kontratash (formati OCDS) me njoftim, oferta, kontratë, pagesa dhe ndryshime; ndërthurur me skemën “CSO Monitor”, ku OSHC-të vëzhgojnë tenderët me vlerë të madhe.
3. **Vendimmarrja e Hapur e Këshillit Bashkiak** – procesverbalet, raportet e komisioneve dhe vendimet ngarkohen brenda 48 orëve; publikohen gjithashtu plani vjetor i konsultimit dhe raporti i transparencës së Këshillit Bashkiak.
4. **Raportet e Performancës & Auditit** – audit i brendshëm, raportet e KLSH-së dhe treguesit SIMRI, të etiketuara sipas temës/vitit, duke mundësuar analizë krahasuese ndër vite.
5. **Open Data Officer** – punonjës i dedikuar që siguron cilësinë e dataset-eve, metadatat dhe një feed RSS të përditësuar.
6. **Trajnim “E Drejtë për Informim”** – workshop-e për stafin front office mbi afatet 10-ditore, për të garantuar përgjigje të sakta dhe brenda afateve ligjore.
7. **Databazë GIS e Pronave Publike** – hartë interaktive me statusin juridik të çdo pasurie, e lidhur me Buxhetin e Hapur për të treguar investimet sipas asetit (në diskutim).
8. **Indeksi vjetor “Trust Elbasan”** – sondazh online dhe intervista në terren që matin besimin e qytetarëve ndaj bashkisë; rezultatet publikohen si dataset i hapur dhe vizualizohen në

infografikë. Ky indeks shërben si barometër suksesi për gjithë objektivin, furnizon me të dhëna konkrete Planin e Buxhetimit me Pjesëmarrje dhe raportin vjetor të transparencës, duke treguar qartë fushat ku duhet të fokusohet komunikimi dhe ku kërkohet përmirësim i shërbimeve.

## Përmbledhje

Transparenca proaktive është **gur themeli i llogaridhënies publike**:

- zvogëlon asimetrinë e informacionit mes administratës dhe qytetareve/qytetarëve,
- ul hapësirën për korrupsion duke ekspozuar proceset vendimmarrëse në kohë reale,
- rrit besimin institucional, dhe
- nxit përdorimin e të dhënave nga OSHC-të, mediat, bizneset dhe akademia për analiza e shërbime që shtojnë vlerë ekonomike e sociale.

### 3) Objektivi OS-3 – Zhvillim i Burimeve Njerëzore:

Ky objektivi synon rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe këshilltareve/këshilltarëve bashkiakë në fusha si etika, konfliktet e interesit dhe sinjalizimi, duke siguruar që moduli e-learning “Integritet & Etikë” të jetë i disponueshëm në Zyrën e Burimeve Njerëzore të Bashkisë për përdorim të përhershëm.

### Shtyllat e zhvillimit të kapaciteteve:

1. **Kalendari i Trajnimeve të Detyrueshme** – sesione vjetore fizike dhe rifreskim i njohurive mbi etikën dhe integritetin. Ky kalendar siguron konsistencë dhe parashikueshmëri, duke lejuar çdo punonjës të dijë paraprakisht kur dhe çfarë trajnimesh do të marrë, pa ndërprerë operacionet. Ky cikël i rregullt krijon një “bosht etik” të përbashkët, përditëson njohuritë ndaj legjislacionit të ri dhe forcon kulturën e përgjegjshmërisë. Përfshin edhe trajnimin “E Drejtë për Informim” – workshop njëditor për punonjësit e bashkisë.

2. **Moduli e-learning “Integritet & Etikë”** – paketë interaktive 5-orëshe (video, kuize, simulime), e ndarë në segmente 15-minutëshe për fleksibilitet maksimal. Funkzioni automatik i ruajtjes së progresit lejon ndjekjen nga zyra ose nga shtëpia. Përmbajtja përfshin studime rasti, skenarë “zgjidh dhe vepro” dhe pyetësorë reflektimi. Sistemi i raportimit në back-end i jep Zyrës së Burimeve Njerëzore pamje të plotë të pjesëmarrjes dhe rezultateve, duke u lidhur me skedat e performancës.
3. **Paketë e brendshme për kuadrin rregullator të bashkisë** – broshurë digjitale dhe seancë hyrëse për punonjëset dhe punojësit e rinj mbi aktet rregullatore bazë.
4. **Rishikim i Përshkrimeve të Punës** – vlerësim dhe përditësim i PP-ve të vjetruara.
5. **Rishikim i Kodit Etik** – përfshirja e VKM nr. 874/2021, me konsultim publik dhe miratim në Këshillin Bashkiak.
6. **Deklaratë njohjeje dhe informim** – modul dy-orësh; punonjësit/punojëset e bashkisë dhe praktikante/praktikantët nënshkruajnë Kodin e Sjelljes para nisjes së internship-it.
7. **Monitorimi i përfaqësimit në drejtim** – Për të siguruar balancë gjinore dhe diversitet në nivelet e vendimmarrjes administrative, Bashkia Elbasan do të monitorojë përqindjen e grave dhe përfaqësuesve të grupeve të nënpërfaqësuar në pozita drejtuese. Të dhënat do të mbledhen çdo gjashtë muaj, duke shërbyer si bazë për vendime mbi zhvillimin e kapaciteteve, mentorimin dhe promovimin mbi bazë meritash. Rezultatet do të publikohen në raportin vjetor të burimeve njerëzore dhe do të diskutohen në kuadër të takimeve të Forumit të Integritetit dhe Këshillit Bashkiak, për të garantuar transparencë dhe llogaridhënie
8. **Trajnime për Këshilltarët dhe Këshilltarët Bashkiakë** – Këshilltarët/ët bashkiakë janë linja e parë e mbikëqyrjes demokratike mbi ekzekutivin vendor; aftësimi i tyre në parimet e integritetit i pajis me mjetet për të identifikuar shkeljet, për të ushtruar kontroll efektiv mbi buxhetin dhe për të komunikuar në mënyrë të qartë me zgjedhësit. Trajnimet e dedikuara, të përshtatura për rolin politik dhe funksionin e mbikëqyrjes, sigurojnë që çdo vendim i Këshillit të reflektojë standardet më të larta etike dhe të rrisë besimin publik në procesin vendimmarrës.
9. **Auditimi i Aksesit në Shërbimet Publike** – Bashkia Elbasan do të kryejë një auditim të brendshëm të të gjitha shërbimeve publike për të vlerësuar nivelin e aksesit për gratë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet rom dhe egjiptian, si dhe të moshuarve.

Rezultatet do të përkthehen në një “Hartë të Aksesit” të publikuar online, e cila do të përditësohet çdo vit. Objektivi është që deri në fund të vitit 2028, të paktën 90% e shërbimeve të kenë akses të barabartë, si në infrastrukturë, ashtu edhe në informacion dhe procedura. Kjo nismë do të orientojë planifikimin buxhetor dhe investimet për përmirësime të mjediseve dhe procedurave të ofrimit të shërbimeve.

10. **Për të garantuar barazi gjinore në proceset e punësimit**, Bashkia Elbasan do të vendosë një mekanizëm monitorimi për çdo konkurs pune, duke raportuar mbi përbërjen gjinore të aplikantëve dhe fituesve. Çdo shpallje vendi pune do të shoqërohet me kritere të qarta dhe të njëjta për të gjithë kandidatet/kandidatët, duke eliminuar mundësinë e diskriminimit gjinor ose social. Rezultatet e analizës gjinore do të publikohen çdo gjashtë muaj në seksionin “Transparenca” të faqes zyrtare të bashkisë. Synimi është që deri në fund të vitit 2028, **100% e konkurseve** të respektojnë standardet e barazisë gjinore, duke siguruar një administratë vendore gjithëpërfshirëse dhe përfaqësuese të komunitetit që shërben.
11. Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve dhe forcimit të etikës institucionale, Bashkia Elbasan do të integrojë në kalendarin vjetor trajnime të detyrueshme **mbi barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin**, si pjesë e Planit të Barazisë Gjinore. Trajnimet do të ofrohen për të gjithë stafin, në formate fizike dhe online, duke përfshirë elementë praktikë, studime rasti dhe udhëzime për zbatimin e standardeve ligjore e etike. Objektivi është që deri në fund të vitit 2028, mbi 90% e stafit të ketë përfunduar këtë trajnim, me raportim gjashtëmujor dhe publikim në faqen zyrtare të bashkisë.

### Rëndësia e vazhdimësisë së trajnimit

Stafi administrativ i bashkisë është në vijën e parë të ofrimit të shërbimeve publike dhe zbatimit të politikave. Mjedisi ligjor, teknologjik dhe procedural ndryshon vazhdimisht. Pa rifreskim të rregullt të njohurive mbi etikën dhe konfliktin e interesit, ekziston rreziku që praktikatat e reja korruptive të mbeten të paidentifikuara. Trajnimi i përhershëm:

- siguron njohuri të përditësuara mbi standardet ligjore,
- forcon kulturën organizative dhe etikën institucionale,
- ul rezistencën ndaj reformave digjitale,
- krijon një cikël pozitiv ku praktikatat e mira përhapen në gjithë administratën.

#### 4) **Objektivi OS-4 – Mekanizma të Pjesëmarrjes Qytetare**

**Qëllimi:** Të institucionalizohet një infrastrukturë e qëndrueshme për pjesëmarrjen qytetare, që përfshin Buxhetimin me Pjesëmarrje ( $\geq 5\%$  e buxhetit zhvillimor) dhe “Ditët e Hapura Kundër Korrupsionit” dy herë në vit, duke garantuar angazhim të gjerë të qytetarëve, OSHC-ve dhe Këshillit Bashkiak deri në fund të vitit 2028. Kjo infrastrukturë i jep qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe Këshillit Bashkiak role të qarta, mjete dhe kanale të rregullta dialogu për të bashkëvendosur mbi prioritetet zhvillimore dhe për të mbikëqyrur menaxhimin e fondeve publike.

#### **Komponentët kryesorë të OS-4:**

1. **Buxhetimi me Pjesëmarrje** – proces vjetor ku qytetaret dhe qytetarët propozojnë dhe votojnë projekte komunitare, me të paktën  $5\%$  të fondit zhvillimor (~ 120 mln lekë në 2026). Me një linjë shtesë prej 0.1 mln lekë/vit, procesi shtrihet në lagjet rome dhe egjiptiane (Rapishte, Mëhalla e Madhe), duke mbuluar transportin, përkthimin komunitar dhe sesionet informuese. Ky mekanizëm i bën qytetarët bashkautorë në vendimmarrjen financiare, rrit transparencën fiskale, forcon pronësinë mbi fondet publike dhe orienton investimet aty ku ndikimi social është më i madh. **Monitorimi i investimeve me ndjeshmëri gjinore dhe sociale** – Brenda procesit të buxhetimit me pjesëmarrje dhe planifikimit të përgjithshëm, Bashkia Elbasan do të monitorojë përqindjen e investimeve që adresojnë nevoja të grave, vajzave dhe grupeve të marginalizuara. Projektet do të kategorizohen sipas target-grupeve përfituese dhe përqindja e fondeve të dedikuara do të raportohet publikisht çdo vit, duke siguruar orientim të drejtë të burimeve financiare dhe rritje të transparencës fiskale.
2. **Ditët e Hapura Kundër Korrupsionit** – dy evente vjetore (prill dhe dhjetor) me ekspozim publik të prokurimeve kryesore, stenda të OSHC-ve dhe sesione pyetje-përgjigje me administratën. Këto forume u japin qytetareve/qytetarëve, mediave dhe shoqërisë civile mundësinë të pyesin drejtpërdrejt për kontratat, shpenzimet dhe progresin e Planit të Integritetit, duke rritur llogaridhënien dhe gjeneruar rekomandime konkrete për përmirësim.
3. **Klubet e Integritetit Rinor** – programe tre mujore në shkollat e mesme me mini-projekte antikorrupsion. Pjesëmarrja e të rinjve krijon një kulturë të hershme të integritetit, duke i

pajisur me mjete kërkimore, aftësi prezantimi dhe kapacitet për të sugjeruar zgjidhje etike në mjedisin e tyre.

4. **Indeksi vjetor “Trust Elbasan”** – sondazh online dhe në terren për të matur besimin e qytetarëve ndaj bashkisë, me publikim të rezultateve si dataset i hapur. Të dhënat krahasohen me njësi vendore të ngjashme për të identifikuar boshllëqe në komunikim dhe cilësinë e shërbimeve. Rekomandimet e dala nga sondazhi integrohen në Planin e Transparencës dhe në Buxhetimin me Pjesëmarrje, duke siguruar që perceptimi publik të reflektohet në politikat vendore.
5. **Platforma “Qytetari Propozon”** – Platformë online dhe pikë fizike pranë Bashkisë për dorëzimin e ideve dhe propozimeve nga qytetarët. Çdo propozim do të ketë status publik të përditësuar (“në shqyrtim”, “pranuar”, “zbatuar”, “refuzuar”) dhe do të gjurmohet progresi në mënyrë transparente. Kjo do të krijojë një mekanizëm të drejtpërdrejtë ndërveprimi midis qytetarëve dhe administratës, duke mundësuar ndjekjen hap pas hapi të zbatimit të ideve.
6. **Raport Alternativ (“Shadow Report”)** – Një OSHC e pavarur, përmes marrëveshjes me Bashkinë, do të hartojë çdo vit një raport alternativ mbi ecurinë e Planit të Integritetit. Raporti do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë dhe do të diskutohet në kuadër të “Ditëve të Hapura Kundër Korrupsionit”, duke mundësuar një monitorim të jashtëm dhe të pavarur të masave të planit.
7. Në kuadër të monitorimit të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse, çdo proces konsultimi publik do të regjistrojë dhe raportojë përqindjen e pjesëmarrësve që janë gra, vajza dhe/ose përfaqësues të grupeve vulnerabël, me synimin për të rritur balancën gjinore dhe përfaqësimin e barabartë në proceset vendimmarrëse.
8. **Monitorimi i iniciativave nga gratë këshilltare** – Për të garantuar një përfaqësim të balancuar gjinor në vendimmarrjen lokale, çdo proces konsultimi dhe punë e Këshillit Bashkiak do të monitorojë dhe raportojë përqindjen e iniciativave të propozuara nga gratë këshilltare. Të dhënat do të publikohen gjashtëmujorisht dhe do të diskutohen në kuadër të “Ditëve të Hapura Kundër Korrupsionit”, duke mundësuar rritjen e transparencës dhe promovimin e pjesëmarrjes së barabartë.

### III. Proçesi dhe Metodologjia

Procesi i hartimit të Planit të Integritetit (PI) u zhvillua nga muaji prill - korrik 2025, duke kombinuar metoda sasiore dhe cilësore për të siguruar një diagnozë të plotë të risqeve të integritetit dhe për të përcaktuar masat përkatëse, në përputhje me:

- VKM nr. 241/2018;
- Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për NJVV (MD, 2019);
- Standardet ndërkombëtare ISO 37001 (Sistemet Antikorrupsion) dhe ISO 31000

(Menaxhimi i Riskut).

#### Struktura organizative e procesit

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë u ngrit një grup pune me përfaqësues nga të gjitha drejtoritë e Bashkisë Elbasan. Grupi u kryesua nga Këshilltari në Kabinetin e Kryetarit dhe përfshinte:

- Koordinatorin/Koordinatoren e Integritetit, të Performancës, të Barazisë Gjinore dhe të së Drejtës për Informim;
- Përfaqësues/e të Forumit Lokal OGP;
- Përfaqësues/e të drejtorive me risk të lartë sipas metodologjisë;
- Njësi teknike për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave.

Ky konfigurim siguroi që çdo fushë me risk të kishte ekspertizë të dedikuar dhe që konsultimi qytetar të përfshihej që në fazat e hershme të procesit. Dizajni i anketave dhe fokus-grupeve u mbështet mbi gjetjet dhe rekomandimet e Planit të Integritetit 2020–2022, duke garantuar vijueshmëri metodologjike dhe krahasueshmëri të rezultateve.

#### 3.1. Hapat e Procesit të Hartimit

##### Hapi 1 – Vlerësimi Sasiore

U realizua përmes një anketimi elektronik me 104 punonjëse/punonjës (kampion përfaqësues i 300 të punësuarve aktivë në bashki), duke garantuar një gabim statistikor  $\pm 5\%$  në nivel besueshmërie 95 %.

Pyetësori me 32 indikatorë matës sondoi perceptimet mbi:

- a) Konfliktin e interesit;
- b) Transparencën e prokurimeve;
- c) Respektimin e Kodit të Sjelljes;
- d) Efikasitetin e kontrolleve të brendshme.

Të dhënat u përpunuan përmes një dashboard-i të treguesve të performancës (KPI), që gjeneroi raportim automatik dhe mundësoi krahasimin me rezultatet e planit të integritetit të mëparshëm.

## Hapi 2 – Vlerësimi Cilësor

U zhvillua nëpërmjet:

- Fokus-grupeve në nivel drejtorish;
- Analizës së kuadrit të brendshëm rregullator;
- Shqyrtimit të raporteve të auditimit, të KLSH-së dhe të OSHC-ve.

Analiza u udhëhoq nga modeli i “6 shtyllave të integritetit”:

1. Buxheti dhe Prokurimi Publik;
2. Administrimi i Pronës Publike;
3. Burimet Njerëzore;
4. Planifikimi Urban;
5. Shërbimet Publike;
6. Kontrolli i Brendshëm.

## Hapi 3 – Vlerësimi i Risqeve

U bazua në tre dimensione të ndërvarura:

- Probabiliteti i shfaqjes së ngjarjes;
- Impakti mbi integritetin institucional dhe besimin publik;
- Efikasiteti i kontrolleve ekzistuese.

Çdo dimension u notua me vlerë nga 1 në 3, sipas një udhëzuesi të standardizuar për të shmangur subjektivitetin. Shuma e tre dimensioneve gjeneroi pikëzimin total për secilin risk, të koduar sipas “semaforit të riskut”:

- **Kuq (> 6)** – rrezik i lartë, masa urgjente;



- Verdhë (3 – 5) – rrezik mesatar, duhet monitoruar;
- Gjellbër ( $\leq 3$ ) – rrezik i ulët.

#### Hapi 4 – Grafiku Kohor i Procesit

- **Prill – Qershor 2025** – Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit 2020–2022 dhe hartimi i raportit përfundimtar.
- **Korrik 2025** – Ngritja e grupit të punës dhe përcaktimi i kalendarit për planin e ri; zhvillimi i anketimit elektronik dhe fokus-grupeve.
- **Korrik – fundi i muajit** – Analiza e të dhënave dhe draftimi i masave.
- **1 Gusht 2025** – Publikimi i draftit të Planit të ri për **konsultim publik** (faqja zyrtare, takime me komunitetin dhe Forumin OGP).
- **Gusht 2025** – Konsultime publike dhe mbledhja e komenteve/rekomandimeve.
- **2 Shtator 2025** – Miratimi i Planit të Integritetit 2025–2028 me **Vendim të Këshillit Bashkiak (VKB)**.

Ky proces garantoj një qasje gjithëpërfshirëse, të bazuar në prova dhe në standarde të matshme, duke krijuar një plan që adreson risqet reale dhe forcon kapacitetet institucionale për integritet.

### 3.2. Buxhetimi i Masave Prioritare

Bashkia Elbasan miratoi buxhetin vjetor 2025 në rreth **5 miliardë lekë** ( $\approx 42$  milion €). Duke respektuar tavanin ligjor që shpenzimet për integritet të mos tejkalojnë **1 %** të buxhetit ( $\approx 50$  milionë lekë në vit), paketa e konsoliduar e masave për katër objektivat kërkon rreth **22 milionë lekë** në vitin e parë, ose **0.44 %** të buxhetit total.

| Blloku i masave             | Investim fillestar (lekë) | Operim vjetor (lekë) | Totali vit 1                       |
|-----------------------------|---------------------------|----------------------|------------------------------------|
| OS-1 – SIMRI                | 5.4 mln                   | 0.3 mln              | 5.7 mln                            |
| OS-2 – Transparencë         | 3.6 mln                   | 1.1 mln              | 4.7 mln                            |
| OS-3 – Burime Njerëzore     | 2.7 mln                   | 1.1 mln              | 3.8 mln                            |
| OS-4 – Pjesëmarrje Qytetare | –                         | 7.8 mln              | 7.8 mln                            |
| <b>TOTAL</b>                | <b>11.7 mln</b>           | <b>10.3 mln</b>      | <b><math>\approx 22</math> mln</b> |

**Si u përlogaritën kostot?**

- **Investimet** (11.7 mln lekë) përfshijnë shpenzimet kapitale një-herëshe: platforma digjitale (OCDS, GIS, e-learning), modernizim serverash, rishikim përshkrimesh pune, paketë orientuese etj.

- **Operimi** (10.3 mln lekë/vit) mbulon trajnimet periodike, forumet “Ditët e Hapura”, Buxhetimin me Pjesëmarrje, sondazhin “Trust Elbasan”, skemën “CSO Monitor” dhe mirëmbajtjen e sistemeve digjitale.

Në buxhetet pasuese, vetëm komponenti operativ (~ 10 mln lekë/vit) përsëritet, ndërsa kostot kapitale amortizohen. Me shpenzime prej 0.44 % të buxhetit, Bashkia mbetet komodisht nën kufirin 1 %, duke lënë ≈ **28 milionë lekë** hapësirë si fond kontingjence për masa të reja ose kosto të paparashikuara gjatë zbatimit.

#### IV. Zbatimi dhe Sistemi i Monitorimit

Kapitulli i zbatimit dhe monitorimit është ndërtuar në përputhje me “Metodologjinë për Monitorimin e Planeve të Integritetit” (Ministria e Drejtësisë, 2021), duke ndërthurur:

- vetëvlerësimin institucional;
- verifikimin e jashtëm; dhe
- angazhimin e aktorëve të jashtëm (qytetarë, OSHC, Këshilli Bashkiak).

Ky sistem synon të sigurojë që progresi ndaj objektivave të Planit të Integritetit (PI) të matet në mënyrë të rregullt, transparente dhe të krahasueshme në kohë.

##### 5.1 Strukturat përgjegjëse

| NIVELI     | ORGANIZMI PËRGJEGJËS                                                                                                                                                                                                                                                                                          | DETYRAT KRYESORE                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| STRATEGJIK | Kryetari i Bashkisë                                                                                                                                                                                                                                                                                           | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Miraton planin vjetor të monitorimit;</li> <li>- Shqyrton raportet ndërmjetëse dhe vjetore;</li> <li>- Propozon masa korrigjuese dhe mbikëqyr zbatimin e tyre.</li> </ul>                                                                                                |
| OPERATIV   | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Koordinator/Koordinatorja e Integritetit (caktuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë)</li> <li>- Koordinator/Koordinatorja e Performancës</li> <li>- Koordinator/Koordinatorja e së Drejtës për Informim</li> <li>- Nëpunësi/Nëpunësja për Barazi Gjinore</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtojnë procesin e mbledhjes dhe analizës së të dhënave;</li> <li>- Koordinojnë Njësitë e Kontaktit në çdo drejtori;</li> <li>- Përgatisin raportet tremujore dhe vjetore;</li> <li>- Raportojnë periodikisht te Kryetari i Bashkisë dhe Komiteti Drejtues.</li> </ul> |
| TEKNIK     | Njësitë e Kontaktit (1 specialiste/specialist për çdo drejtori bashkiake)                                                                                                                                                                                                                                     | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Plotësojnë formularët standardë të monitorimit;</li> <li>- Azhurnojnë matricën e riskut të integritetit;</li> <li>- Sigurojnë evidencat dokumentare për masat e zbatuara.</li> </ul>                                                                                     |

## 5.2. Proçesi i ciklit vjetor

| 22 | Mungesa e publikimit të planit vjetor të konsultimeve publike dhe raportit vjetor të transparencës | Mesatar | <b>Plan Konsultimi &amp; Raport Transparence KB</b> | <b>Hartimi dhe publikimi i kalendarit vjetor të konsultimeve publike. Përgatitja e raportit vjetor të transparencës së Këshillit Bashkiak. Diskutimi publik i raportit gjatë Ditëve të Hapura për Transparencën.</b>                | <i>Koordinatorja/Koordinatori për Njohimin dhe Konsultimin Publik &amp; Sekretaria e KB – Q4/2026</i> | <i>Objektivi OS-2 – Transparencë &amp; Llogaridhënie</i> | <i>Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme</i> |
| 23 | Mungësë e një databaze elektronike të pronave bashkiake.                                           | Lartë   | <b>Databazë GIS e Pronave</b>                       | <b>Regjistrimi elektronik i të dhënave në GIS. Testimi dhe verifikimi i funksionalitetit. Publikimi online i databazës për qytetarë/qytetarë.</b>                                                                                   | <b>Drejtoria Pronave &amp; Drejtoria TI – Q4/2027</b>                                                 | <i>Objektivi OS-2 – Transparencë &amp; Llogaridhënie</i> | 0.5 milion                                                 |
| 24 | Mungësë e një mekanizmi që mat perceptimin publik / indeks vjetor i besimit publik.                | Mesatar | <b>Indeksi “Trust-Elbas a”</b>                      | <b>Dizajnimi i pyetësorit (online + terren). Realizimi i sondazhit çdo vit. Përpunimi dhe publikimi i rezultateve në faqen zyrtare dhe në raportet e transparencës. Diskutim i gjetjeve me Forumin OGP dhe qytetarët/qytetarët.</b> | <b>Koordinatorja/Koordinatori i Performancës; Forumi OGP Q1/2026 → çdo vit</b>                        | <i>Objektivi OS-2 – Transparencë &amp; Llogaridhënie</i> | <i>Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme</i> |

|    |                                                                                                                                       |         |                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                      |                                               |                                                     |
|----|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|-----------------------------------------------------|
| 25 | Mungesa e transparencës në vendimmarrje dhe mungesa e kohës së mjaftueshme për koment publik mbi projekt-vendimet me ndikim të gjerë. | Lartë   | <b>Publikimi paraprak i projekt-vendimeve kryesore në faqen e Bashkisë për konsultim publik.</b> | <b>Hartimi i listës së kriterëve për përcaktimin e “projekt-vendimeve kryesore” (financiare, planifikuese, rregullatore). Publikimi në faqen zyrtare të Bashkisë së të gjitha projekt-vendimeve që plotësojnë kriteret, minimum 10 ditë pune para miratimit. Krijimi i një seksioni të dedikuar “Konsultim Publik” ku vendosen projekt-vendimet, afatet, dhe mënyrat e dërgimit të komenteve. Raportimi publik vjetor mbi numrin e projekt-vendimeve të publikuara paraprakisht dhe komentet e marra.</b> | Sekretaria e Këshillit Bashkiak dhe Drejtoria IT – Afat: nga viti 2025 dhe në vijim.                                 | Objektivi OS-2 – Transparencë & Llogaridhënie | Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme |
| 26 | Mungesa e ndarjes gjinore në raportet e performancës dhe të ankesave, duke kufizuar analizën e barazisë dhe qasjes gjithëpërfshirëse  | Mesatar | <b>Përfshirja e ndarjes gjinore në raportet vjetore të performancës dhe të ankesave</b>          | <b>Hartimi i formatit standard të raportimit me ndarje gjinore. Trajnimi i stafit përgjegjës për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave sipas gjinisë. Publikimi i raporteve të përditësuara në faqen zyrtare të bashkisë</b>                                                                                                                                                                                                                                                                              | Koordinatorja/Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Drejtoria Juridike<br><br>Janar 2026 dhe çdo vit në vijim | Objektivi OS-2 – Transparencë & Llogaridhënie | Identifikuar dhe kostuar në PVBGJ                   |

|    |                                                                                                                                                                                     |       |                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                          |                                                                                                  |                                                            |
|----|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|-----------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------|
| 27 | Mungesa e publikimit të buxhetit të bashkisë në formate të hapura dhe të përditësuara rregullisht, duke kufizuar analizën e pavarur dhe transparencën fiskale.                      | Lartë | <b>Buxheti i Hapur (PDF + CSV/JSON)</b> | <b>Hartimi dhe miratimi i</b> formatit standard për publikimin e buxhetit në formate të hapura. <b>Publikimi në</b> faqen zyrtare të Bashkisë i buxhetit të miratuar dhe ekzekutimit buxhetor, me përditësim gjashtëmujor. <b>Sigurimi</b> që formatet CSV/JSON janë të lexueshme nga platformat digjitale dhe të aksesueshme për publikun.                                                                                                                                               | <i>Drejtoria e Financës; Drejtoria e IT; Koordinatorja/Koordinatori për të Drejtën e Informimit; Koordinatorja/Koordinatori i Performancës</i><br><b>Nga tremujori 4/2026 e në vijim</b> | <i>Objektivi OS-2 – Transparencë &amp; Llogaridhënie</i>                                         | <i>Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme</i> |
| 28 | Mundësi për konflikt interesi të pa-deklaruar nga këshilltarët/këshilltarët dhe anëtarët/anëtarët e komisioneve të Këshillit Bashkiak gjatë vendimmarrjes.përpara cdo vendimmarrje. | Lartë | <b>Deklaratë interesi ad-hoc</b>        | <b>Draftim dhe miratim i</b> ndryshimeve në Rregulloren e Këshillit Bashkiak për të bërë të detyrueshëm deklarimin e konfliktit të interesit kur këshilltarja/këshilltari ose komisioni ka dijeni për situata të tilla. <b>Hartimi i</b> formatit standard të deklaratës ad hoc. <b>Verifikim</b> ligjor i përputhshmërisë me kuadrin kombëtar dhe me udhëzimet e ILDKPKI-së. <b>Trajnim</b> i këshilltareve/këshilltarëve, sekretarisë së KB dhe komisioneve mbi procedurat e deklarimit | Sekretaria e Këshillit Bashkiak; Drejtoria e Burimeve Njerëzore (DBNJ) dhe Koordinatorja/Koordinatori i Performancës<br><b>Q1 2026</b>                                                   | <i>Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit</i> | 0.2 milionë lekë                                           |

|    |                                                                                                                                                                                                           |       |                                                                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |                                                                                                                                                       |                                                                                                  |                                                                      |  |
|----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------|--|
|    |                                                                                                                                                                                                           |       |                                                                                                  | dhe përjashtimit nga vendimmarrja                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            |                                                                                                                                                       |                                                                                                  |                                                                      |  |
| 29 | Mosfunksionim i plotë dhe jo i unifikuar i sporteleve “One Stop Shop” në njësitë administrative dhe në qendrën e Bashkisë, për shkak të mungesës së një protokolli të brendshëm dhe standardeve të qarta. | Lartë | Standardizim & Hartimi dhe zbatimi i Rregullores së Brendshme për funksionimin e “One Stop Shop” | <b>Audit</b> i proceseve ekzistuese në sportelet e Bashkisë dhe njësitë administrative. <b>Hartimi i Rregullores</b> së Brendshme/Protokollit për funksionimin e sportelit, duke përcaktuar: 1.shërbimet që ofrohen dhe mënyrën e ofrimit; 2. afatet e shërbimit për çdo kategori dokumenti; 3. detyrimet e punonjësve/punonjësve dhe të drejtat e qytetarëve/qytetarëve; 4. procedurat për rastet e emergjencës (server/back-up). <b>Miratimi</b> i rregullores dhe trajnimi i stafit për zbatimin. <b>Publikimi</b> i një SLA (Marrëveshje për Nivelin e Shërbimit) për qytetarët në faqen e Bashkisë. <b>Vendosja e monitorimit</b> mujor përmes KPI-ve (koha mesatare e shërbimit, numri i ankesave, niveli i kënaqësisë së qytetarëve). | Grup pune i drejtuar nga Nënkryetari i Bashkisë; Drejtoria e IT-së; Drejtoria Juridike Koordinatorja/Koordinatori i Performancës.<br><b>Q4 - 2026</b> | <i>Objekti OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integrimit të Menaxhimit të Riskut të Integritetit</i> | 0.35 mln lekë (investim fillestar) + 0.05 mln lekë/vit (mirëmbajtje) |  |
| 30 | Mungon punonjësi i dedikuar për të dhënat e hapura.                                                                                                                                                       | Lartë | Emërimi i një punonjësi “Open-Data Officer”                                                      | Vendim i Kryetarit; përshkrim pune; trajnimi fillestar                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       | Drejtoria BNU, Koordinator i Performancës & Kryetari – <b>Q1/2026</b>                                                                                 | <i>Objekti OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integrimit të Menaxhimit të Riskut të Integritetit</i> | Pa kosto shtesë – i deleguar një punonjësi ekzistues                 |  |

|    |                                                                                 |         |                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                                                   |                                                                                           |                                                     |
|----|---------------------------------------------------------------------------------|---------|---------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|
| 31 | Kodi Etik i pa përditësuar (me përcaktimet e VKM nr.874/2021)                   | Mesatar | Rishikim i Kodit Etik + elementët e rinj    | Draft ndryshimesh; konsultim; miratim                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                            | Grup pune me punonjëse/punonjës nga Drejtoria Juridike & BNJ; Koordinatorja/Koordinatori i Integritetit, Koordinatorja/Koordinatori i Performancës <b>Q4/2025</b> | Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit | Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme |
| 32 | Kodi Etik nuk njihet nga praktikantët/ët që kryejnë intershipin në institucion. | Mesatar | Deklaratë njohjeje + trajnime praktikantësh | Përfshirje subjektsh; modul 2-orësh                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | Drejtoria BNJ; Koordinatorja/Koordinatori i Performancës– <b>Q2/2026</b>                                                                                          | Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit | Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme |
| 33 | Mungesë e një procedurë standarde për ekspertizë të jashtme.                    | Mesatar | Manual “Prokurime Expertizash”              | <b>Hartohet</b> një manual i brendshëm (“Prokurime Expertizash”), ku përcaktohen: rastet kur Bashkia ka të drejtë të kontraktojë ekspertë të jashtëm, kriteret epërzgjedhjes së ekspertëve, dokumentacioni i nevojshëm, procedurat e prokurimit (p.sh. shërbime me vlerë të vogël, garë e hapur, kontrata direkte sipas VKM), mënyra e raportimit dhe monitorimit të ekspertëve. Ky manual do të <b>miratohet</b> si akt i brendshëm i Bashkisë. | Njësia Prokurime – <b>Q3/2026</b>                                                                                                                                 | Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit | Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme |



|    |                                                                                                                                              |         |                                                                                                                                                         |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                       |                                                                                                                                      |                                                                                             |                                                     |  |  |
|----|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|--|--|
|    |                                                                                                                                              |         |                                                                                                                                                         | Njësia e Prokurimeve do të trajnohet për zbatimin e manualit.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |                                                                                                                                      |                                                                                             |                                                     |  |  |
| 34 | Mungon mekanizëm i pavarur vëzhgimi për tenderët me vlerë të madhe → rrezik korrupsioni/ zbatim planeve dhe strategjive të bashkise          | Lartë   | Skema “CSO Monitor”                                                                                                                                     | Përditësim OGP-Planit lokal me klauzolë monitorueseThirrje publike & përzgjedhje OSHC-sh monitoruese Përpunim të dhënash dhe analizëPublikim raporte trimestrale të vëzhgimit                                                                                                                                                                                                                                                                                         | Grup pune me punonjës të bashkisë i kryesuar nga nënkryetari i bashkisë, Koordinator i Drejtës së Infomimit dhe Forumi OGP – Q2 2026 | Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integrimit të Menaxhimit të Riskut të Integritetit | Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme |  |  |
| 35 | Mungesa e evidentimit, treguesve dhe raportimit të rasteve të shkeljeve të etikës, diskriminimit (gjynor/social/etnik) dhe antikorrupsionit. | Mesatar | Vendosja e një sistemi të unifikuar për raportimin, kategorizimin dhe monitorimin e rasteve të shkeljeve të etikës, diskriminimit dhe antikorrupsionit. | Hartimi i procedurës së standardizuar për marrjen dhe shqyrtimin e ankesave dhe sinjalizimeve.Regjistrimi dhe kategorizimi i rasteve sipas llojit (etikë, diskriminim gjynor/social/etnik, antikorrupsion).Vendosja e indikatorit “% e rasteve të trajtuara nga autoritetet kompetente(AK/AKP)” R raportim periodik (çdo 6 muaj) në Forumin e Integritetit dhe përfshirje në raportin vjetor të Planit të Integritetit.Publicim on-line i të dhënave të përmbledhura. | Koordinatori i Integritetit dhe Performancës, Drejtorja e Burimeve Njerëzore — Afati: Dhjetor 2026 dhe çdo vit në vijim              | Objektivi OS-1: Konsolidim i Sistemit të Integrimit të Menaxhimit të Riskut të Integritetit | Pa kosto shtesë – realizohet me burime të brendshme |  |  |

TABELA PËRMBLEDHËSE SIPAS OBJEKTIVAVE STRATEGJIKË

| OBJEKTIVI STRATEGJIK                                                             | NR. I MASAVE | % E TOTALIT TË MASAVE | BUXHETI TOTAL (MLN LEKË) | % E BUXHETIT TOTAL |
|----------------------------------------------------------------------------------|--------------|-----------------------|--------------------------|--------------------|
| OS-1: KONSOLIDIM I SISTEMIT TË INTEGRUAR TË MENAXHIMIT TË RISKUT TË INTEGRITETIT | 11           | 31.4%                 | 1.75                     | 8.9%               |
| OS-2: TRANSPARENCË & LLOGARIDHËNIE                                               | 9            | 25.7%                 | 2.64                     | 13.6%              |
| OS-3: ZHVILLIM I BURIMEVE NJERËZORE                                              | 10           | 28.6%                 | 4.80                     | 24.4%              |
| OS-4: MEKANIZMA TË PJESËMARRJES QYTETARE                                         | 5            | 14.3%                 | 10.50                    | 53.1%              |
| <b>TOTAL</b>                                                                     | <b>35</b>    | <b>100%</b>           | <b>19.7</b>              | <b>100%</b>        |

#### Analizë Përfundimtare mbi Buxhetimin dhe Masat

Plani i Integritetit 2025–2028 për Bashkinë Elbasan konsolidon 35 masa të shpërndara në katër objektiva strategjikë, të balancuara ndërmjet ndërhyrjeve pa kosto shtesë dhe investimeve konkrete financiare.

- **OS-4 (Mekanizmat e Pjesëmarrjes Qytetare)** përbën mbi gjysmën e buxhetit total ( $\approx 53\%$ ), duke reflektuar prioritetin e bashkisë për të rritur angazhimin qytetar, buxhetimin me pjesëmarrje dhe transparencën fiskale.
- **OS-3 (Zhvillimi i Burimeve Njerëzore)** mban peshën e dytë më të madhe buxhetore ( $\approx 24\%$ ), duke garantuar që integriteti të mbështetet në një administratë të trajnuar dhe gjithëpërfshirëse.
- **OS-2 (Transparencë & Llogaridhënie)** zë një pjesë të konsiderueshme ( $\approx 13.6\%$ ), me fokus tek buxheti i hapur, prokurimet e hapura dhe raportimi publik.

- **OS-1 (Sistemi i Integruar i Menaxhimit të Riskut të Integritetit)** përfshin më shumë masa pa kosto shtesë, duke përdorur kapacitetet e brendshme dhe duke adresuar risqet përmes rregulloreve, manualeve dhe mekanizmave të rinj monitorimi.

Në terma financiarë, totali i parashikuar për vitin e parë arrin në **19.7 milionë lekë**, që përfaqëson vetëm **0.44% të buxhetit total vjetor të Bashkisë**. Ky nivel është dukshëm nën tavanin ligjor prej 1%, duke garantuar një qasje të kujdesshme fiskale dhe duke lënë hapësirë për manovrim në rast të kostove të paparashikuara.

➡ Në përfundim, Plani i Integritetit është i balancuar: **ka kosto të arsyeshme, përqendrohet tek pjesëmarrja dhe transparencia**, dhe garanton qëndrueshmëri duke u mbështetur si në burime të brendshme, ashtu edhe në instrumente të rinj monitorimi.

*Aneksat që vijojnë janë pjesë integrale e Planit të Integritetit 2025–2028 dhe kanë karakter zbatues e sqarues për masat e përcaktuara në dokument*

## ANEKSI 1 – Mekanizmi i Monitorimit të Planit të Integritetit

### Qëllimi:

Të sigurojë që zbatimi i masave të Planit të Integritetit 2025–2029 monitorohet në mënyrë të vazhdueshme, transparente dhe gjithëpërfshirëse, duke garantuar korrigjimin në kohë të devijimeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

### Strukturat përgjegjëse:

- **Kryetari/ja i/e Bashkisë:** Miraton planin vjetor të monitorimit dhe siguron buxhetin për zbatim.
- **Koordinatori/ja i/e Integritetit:** Drejton procesin teknik të mbledhjes dhe analizës së të dhënave; përgatit raportet tremujore dhe vjetore.
- **Njësitë e Kontaktit në Drejtori:** Raportojnë mbi zbatimin e masave sipas formatit standard.
- **Forumi OGP dhe OSHC-të:** Marrin pjesë në monitorimin e jashtëm dhe hartojnë raporte 6-mujore mbi transparencën dhe etikën.
- **OSHC e pavarur (Shadow Report):** Harton raportin vjetor alternativ mbi zbatimin e planit, i cili publikohet në faqen zyrtare dhe prezantohet në “Ditët e Hapura Kundër Korrupsionit”.

### Procesi vjetor i monitorimit:

1. **Planifikimi (Janar):** Hartohet plani vjetor i monitorimit me afate, përgjegjësi dhe burime.
2. **Mbledhja e të dhënave:** Njësitë e kontaktit dorëzojnë evidencat për çdo masë dhe përditësojnë matricën e riskut.
3. **Mbledhje gjashtëmujore të hapura:** Organizohen me OSHC-të, grupet e interesit dhe median për të diskutuar progresin. Rekomandimet e dala publikohen në faqen e Bashkisë brenda 15 ditëve.
4. **Raportimi tremujor:** Raporte ndërmjetëse për diskutim në nivel drejtues dhe me Forumin OGP.
5. **Raporti vjetor i integritetit:** Publikohet online dhe i dorëzohet Këshillit Bashkiak.
6. **Rishikimi:** Përditësimi i matricës së riskut dhe planifikimi i vitit pasardhës.

**Indikatorët kryesorë të monitorimit:**

- Përqindja e qytetareve dhe qytetarëve që marrin pjesë në konsultime publike për integritetin.
- Përqindja e qytetareve dhe qytetarëve që paraqesin ide/propozime përmes platformës “Qytetari Propozon” ose kanaleve të tjera zyrtare.
- Përqindja e qytetareve dhe qytetarëve që ndjekin online buxhetin dhe raportet financiare të Bashkisë.
- Numri i rekomandimeve të dala nga mbledhjet gjashtëmujore dhe përqindja e tyre të adresuara brenda vitit.

**ANEKSI 2 – Përputhshmëria me Standardet Ndërkombëtare dhe Kombëtare**

**Kuadri ligjor dhe strategjik kombëtar:**

- **Ligji nr. 139/2015** “Për vetëqeverisjen vendore”
- **Ligji nr. 60/2016** “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”
- **Ligji nr. 119/2014** “Për të drejtën e informimit”
- **VKM nr. 241/2018** për masat e integritetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore
- **VKM nr. 873/2021** për konfliktin e interesit, deklarinimin e pasurisë dhe sjelljen etike
- **Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit 2024–2030**

**Përputhshmëria ndërkombëtare:**

- **Parimet e Qeverisjes së Hapur (OGP)** – Transparencë, Llogaridhënie, Pjesëmarrje Qytetare.
- **Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC)** – Nenet për transparencën, pjesëmarrjen dhe integritetin institucional.
- **Standardet e Këshillit të Evropës për etikën publike** – Respektimi i Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore.

**Vlerësimi i përputhshmërisë:**

Plani i Integritetit 2025–2029 është konceptuar në përputhje të plotë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar harmonizim vertikal dhe horizontal të masave të tij.

### ANEKSI 3 – Mekanizmi i Sinjalizuesve dhe Mbrojtja e tyre

#### Qëllimi:

Të garantojë raportimin e sigurt të shkeljeve, trajtimin e drejtë dhe mbrojtjen nga hakmarrja për punonjëset/punonjësit dhe qytetaret/qytetarët që sinjalizojnë.

#### Përkufizim:

**Sinjalizuese ose sinjalizues** është çdo punonjëse/punonjës, ish-punonjëse/ish-punonjës ose palë e tretë që raporton ose bën publikisht të ditur shkelje të dyshuara të ligjit, rregullave apo standardeve etike të Bashkisë Elbasan.

#### Procedura:

1. **Raportimi i brendshëm:** Drejtohet tek Koordinatorja/Koordinatori i Integritetit përmes formularit standard dhe kanalit të sigurt (email i dedikuar ose kuti fizike të mbyllura).
2. **Raportimi i jashtëm:** Tek ILDKPKI ose autoritete të tjera sipas Ligjit nr. 60/2016.
3. **Afati i shqyrtimit:** Brenda 30 ditëve nga marrja e raportimit duhet të jepet përgjigje sinjalizueses/sinjalizuesit.

#### Mbrojtja:

- Anonimiteti i sinjalizueses/sinjalizuesit ruhet në çdo fazë të procesit;
- Ndalohet çdo formë diskriminimi, penalizimi apo hakmarrjeje ndaj sinjalizueses/sinjalizuesit;
- Masa disiplinore merren ndaj kujtdo që cenon mbrojtjen e tyre.

#### Raportimi vjetor:

Koordinatorja/Koordinatori i Integritetit përfshin në raportin vjetor numrin dhe kategorinë e sinjalizimeve, masat e marra dhe statusin e tyre.

**Konceptoi:** Koordinatorja P. L. Haxhiymeri

**Pranoi:** Këshilltari E. Muço

Drejtorja J. A. Hoxha

Drejt. BNJ L. Dervish

Drejt. Audi Q. Tusha

**Miratoi:** ZV/Kryetar A. Sula

KRYETARI  
Gledian LLATJA